



RECON

RE-valuation of Cultural-Heritage,
Knowledge and Opportunity Network



RECON është një projekt i financuar nga **Programi Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi 2014/2020**, qëllimi i të cilit është modernizimi i aktiviteteve arkivore dhe hartëzimi i koleksioneve të trashëgimisë kulturore për të investuar në industrinë kreative si një çelës për krijimin e një qasje strategjike, afatgjatë dhe inovative për aksesin në elementet arkivore.

PARTNERËT E PROJEKTIT

Kinoteka e Malit të Zi (Mali i Zi)
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (Shqipëri)
Fondacioni i Komisionit të Filmit në Pulia (Itali)
Komuna e Termolit (Itali)



OBJEKTIVAT

- 1 Standardizimi i katalogut të trashëgimisë kulturore filmike të partnerëve të projektit me qëllim përmirësimin e planifikimit dhe zbatimit të masave konservuese dhe restauruese të trashëgimisë audiovizive.
- 2 Përmirësimi i aplikacionit web me ndërfaqe në katër gjuhë dhe përdorim praktik midis institucioneve, profesionistëve dhe publikut të gjerë, i dobishëm për përgatitjen e raporteve administrative, menaxhuese dhe statistikore dhe monitorimin e gjendjes së trashëgimisë filmike në lidhje me shkaqet kryesore të degradimit të filmit.



REZULTATET E PRITURA

- 1 Krijimi i një versioni të përmirësuar të aplikacionit në internet që arkivistët dhe studiuesit do ta përdornin për arkivimin e saktë metodik të filmave dhe materialeve të tjera video.
- 2 Krijimi i një strategjie të ngritjes së kapaciteteve dhe restaurimit të materialeve të përzgjedhura dhe sërish vendosja në sistem në dispozicion të publikut duke përdorur aplikacionin në internet.

TAKIMI FILLESTAR NË PODGORICË

Takimi fillestar i projektit RECON u mbajt në nëntor 2021, në Podgoricë, Mali i Zi dhe pa përfshirjen dhe pjesëmarrjen e katër partnerëve të projektit. Për shkak të situatës pandemike nga Covid-19, takimi u zhvillua në modalitetin hibrid duke lejuar partnerët e projektit të marrin pjesë si në sallë dhe në internet. Në fund të takimit u organizua një konferencë për shtyp.



Aktiviteti ishte një mundësi që pjesëmarrësit të njiheshin me njëri-tjetrin por mbi të gjitha të prezantonin projektin, objektivat dhe aktivitetet e planifikuara të tij, si dhe rezultatet që do të arriheshin.

AKTIVITETET TRAJNUESE MBI PËRDORIMIN E DREJTË, IDENTIFIKIM DHE KONSERVIMIN E FILMAVE

Aktivitetet trajnuese, të organizuara nga Kinemateka e Malit të Zi, nga data 28 shkurt deri më 4 mars 2022 patën nderin të presin Camille Blot-Wellens, arkiviste filmi, studiuese, historiane dhe profesore në Universitetet e Parisit 8 dhe Lozanës, e cila mbajti konferencën hyrëse dhe punëtorinë. Prania e Camille ishte një vlerë e shtuar për të gjithë pjesëmarrësit që patën mundësinë të fitonin aftësi dhe njohuri specifike dhe të zbatonin atë që mësuuan.



STANDARDIZIMI I KATALOGIMIT PËRMES FJALORIT TË KONTROLLUAR SHUMËGJUHËSOR NË TERMA TË PËRGJITHSHËM TË NJOHURA

Workshopi i organizuar nga Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, u mbajt në Tiranë nga data 7 deri më 11 mars 2022. Pesë ditë plot aktivitete ku morën pjesë një grup pune i specializuar, i përbërë nga dy anëtarë të projektit RECON, Kinemateka e Malit të Zi dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit si dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm. Në punëtori ishte edhe prezenca e ekspertit Georg Eckes, Drejtues i Institutit Gjerman të Filmit.



E drejta e autorit © 2022 | Projekti RECON

Ju e keni marrë këtë mesazh sepse jeni abonuar në një listë të postimeve të partnerëve RECON. Nëse nuk dëshironi të merrni email të mëtejshëm nga ne, mund të anuloni abonimin tuaj në listën e postimeve duke iu përgjigjur kësaj e-mail.

Ky projekt është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II).